

TË DREJTAT E NJERIUT NË FOKUS HUMAN RIGHTS IN THE SPOTLIGHT

70
YEARS
UNIVERSAL DECLARATION OF
HUMAN RIGHTS
#STANDUP4HUMANRIGHTS



FJALA HYRËSE

I dashur lexues,



Koordinator i Përhershëm
i Kombeve të Bashkuara
Brian Williams
United Nations
Resident Coordinator

Këtë vit Shqipëria i bashkohet botës në krenimin e një prej momenteve më të rëndësishme në historinë e njerëzimit: Miratimi i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, nënshkruar në Paris më 10 dhjetor 1948. Shtatëdhjetë vite më vonë, ndërsa vërejmë se janë bërë hapa të mëdhenj në përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve në mbarë botën, të drejtat e mishëruara në Deklaratë dhe në Kartën e Kombeve të Bashkuara mbeten ende të pambrojtura sa duhet. Pra, ka ende shumë punë për të bërë.

Në Shqipëri, Kombet e Bashkuara janë krenare që kanë punuar me qeverinë, institucionet e pavarura për të drejtat e njeriut, si institucioni i Avokatit të Popullit apo Komisioneri kundër Diskriminimit, shoqërinë civile dhe të tjerë partnerë, në avancimin e mbrojtjes së të drejtave. Përpjekjet kanë qenë të një game të gjerë, duke përfshirë punën lidhur me të drejtat e fëmijëve, të drejtave e grave dhe vajzave, të drejtat e minoriteteve dhe refugjatëve, të drejtat e atyre që janë përjashtuar nga zhvillimi, atyre që luftojnë kundër stigmatizimit bazuar në orientimin e tyre seksual. Të drejtat e njeriut nuk njohin kohë dhe mbeten një pasaportë e dinjitetit njerëzor.

Axhenda jonë për të drejtat e njeriut njih të drejtat ekonomike dhe sociale, si dhe të drejtat politike. Kombet e Bashkuara punojnë për të zgjeruar qasjen në arsim, kujdes shëndetësor dhe shërbime sociale,

për të rritur mundësitë për punësim dhe për të përmirësuar dialogun social. Ne punojmë në partneritet të ngushtë me shoqërinë civile dhe median, puna e përgjegjshme e të cilëve është mjaft e qenësishme për demokracinë dhe për përmbushjen e Deklaratës. Kombet e Bashkuara kërkojnë të mbështesin fuqizimin e grave, duke përfshirë rritjen e pjesëmarrjes së tyre në jetën politike e publike. Kombet e Bashkuara kanë qenë thellësisht të përfshira në çështjet e qeverisjes, në nivelet vendore dhe kombëtare. Përherë e më tepër, çështjet që përfshijnë klimën nuk po njihen më vetëm si çështje mjedisore por gjithashtu edhe si një e drejtë.

Shqipërisë dhe botës, i mbeten vetëm 12 vjet për të përmbushur Axhendën 2030 dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Të drejtat e njeriut qëndrojnë në themel të kësaj axhende: “të mos lëmë askënd pas” nënkupton mbrojtjen e të drejtave të shtresave më të marginalizuara dhe ndërtimin e shoqërive gjithëpërfshirëse me institucione të përgjegjshme.

Kjo broshurë është një dokument që tregon se si ne po e rrisim vëmendjen ndaj të drejtave të njeriut në Shqipëri. Njerëzit flasin me zërin e tyre. Ju ftoj të lexoni historitë e tyre dhe #standupforhumanrights (të mbështesni të drejtat e njeriut).

Dear reader,

This year Albania joins the world in celebrating one of the most significant moments in the history of human kind: The adoption of the Universal Declaration of Human Rights, signed in Paris on 10 December 1948. Seventy years later we find that while huge strides have been made in advancing the quality of people's lives across the planet, the rights enshrined in the Declaration and the United Nations Charter are still not protected enough – much more remains to be done.

In Albania, the United Nations has been proud to work with Government, independent human rights institutions like the People's Advocate or the Anti-Discrimination Commissioner, civil society and other partners to advance the protection of rights. Efforts have been wide-ranging, including work concerning the rights of children, the rights of women and girls, the rights of minorities and refugees, the rights of those excluded from development, those fighting stigma because of their sexual orientation, human rights are timeless and remain a passport to human dignity. Our human rights agenda recognizes economic and social as well as political rights. The UN works to expand

access to education, health care and social services, enhance employment opportunities and improve social dialogue. We partner closely with civil society and the media, whose accountable functioning is essential for democracy, and the realization of the Declaration. The UN seeks to support the empowerment of women, including increased participation of women in political and public life. The UN has been deeply involved in governance issues, at local and national levels. Increasingly, the climate is recognized not just as an environmental issue, but also one of rights.

Albania and the world only have 12 years left to achieve Agenda 2030 and the 17 Sustainable Development Goals. Human rights lie at the core of this agenda: to 'leave no one behind' means to protect the rights of the most marginalized, and build inclusive societies with accountable institutions.

This brochure is a record of how we are boosting human rights in Albania. People speak for themselves. I invite you to read their stories and #standupforhumanrights.

FOREWORD

Semiha Xhani po lufton që të mos ta nxjerrin nga shtëpia e saj. Ajo e ndërtoi shtëpinë së bashku me ish-bashkëshortin e saj por nuk ishte e regjistruar si bashkëpronare. Semihaja është përfaqësuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, e cila me anë të mbështetjes së Kombeve të Bashkuara, ka ofruar këshillim ligjor falas dhe përfaqësim në gjykatë për çështjet e pronësisë për më shumë se 200 gra në nevojë të prekura nga ky problem. Qendra ka punuar në dhjetë bashki në të gjithë Shqipërinë, për të rritur qasjen në informacion për të drejtat pronësore të grave. Projekti u financua nga qeveria suedeze dhe tashmë vijon të financohet nga UN Women. Vetëm 8 për qind e grave në Shqipëri janë të regjistruara si pronare toke. Të drejtat e barabarta të grave për të pasur tokë dhe pronë konsiderohen si një e drejtë e njeriut.

Semiha Xhani is struggling not to get evicted from her house. She built it together with her ex-husband but was not registered as a co-owner. Semiha has been represented by the Centre for Legal and Civic Initiatives, which with the support of UN has been offering free legal counseling and representation in court on property related cases to 200 + vulnerable women. The center p has worked in ten municipalities

SEMIHA

across Albania, to increase access to information about women's property rights. The project was funded by the Government of Sweden and currently by UN Women. Only 8 per cent of women in Albania are registered as land owners. Women's equal right to land and property is a human right.



Shkurte Goci është kryefamiljare dhe nënë e tre fëmijëve. Për vite me radhë, ajo ka prodhuar dhe shitur veshje tradicionale shqiptare. Vetëm së fundmi, ajo arriti të hapë një dyqan e ta regjistrojë biznesin e saj. Ajo është një prej 18 përfitueseve të Fondit të Grave Sipërmarrëse, që u ngrit për herë të parë në vitin 2016 nga Bashkia e Tiranës me mbështetjen teknike të Kombeve të Bashkuara dhe me financime të qeverisë suedeze. Shkurte e ka tanimë të mundur të rrisë të ardhurat e saj dhe të kontribuojë në shoqëri duke paguar taksat. Gratë drejtojnë vetëm 28,5% të të gjitha sipërmarrjeve në Shqipëri dhe ato përballen me më shumë sfida se sa burrat për të ngritur dhe administruar bizneset e tyre.

SHKURTE

Shkurte Goci is the head of the household and a mother of three. For years, she has been producing and selling traditional Albanian clothes. Only recently she managed to open a store and register her business. She is one of the 18 beneficiaries of the Women's Entrepreneurs Fund, which was established for the first time in 2016 by the Municipality of Tirana with UN technical support and funds from the Swedish Government. Shkurte is now able to increase her income and contribute to society by paying taxes. Women lead only 28.5% of all enterprises in Albania and they face more challenges than men to establish and manage their own businesses.



Gratë përfaqësojnë 35% të anëtarëve të këshillit bashkiak. Pjesëmarrja e barabartë e grave në jetën politike dhe publike konsiderohet si një e drejtë e njeriut. Është krijuar një Rrjet Kombëtar i Aleancave të Grave Këshilltare në Shqipëri, në mbështetje të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në proceset vendimmarrëse. Ky rrjet përbëhet nga 18

aleanca nga disa bashki të ndryshme, që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e popullsisë së vendit. UN Women, me financimin e qeverisë suedeze, ka dhënë mbështetje teknike në krijimin dhe fuqizimin e tetë aleancave. Pjesëmarrja e barabartë e grave në jetën politike dhe publike konsiderohet si një e drejtë e njeriut.

PJESËMARRJA E BARABARTË E GRAVE NË JETËN POLITIKE DHE PUBLIKE KONSIDEROHET SI NJË E DREJTË E NJERIUT.



WOMEN'S EQUAL PARTICIPATION IN THE POLITICAL AND PUBLIC LIFE IS A HUMAN RIGHT.

Women represent 35% of the municipal council members. Women's equal participation in the political and public life is a human right. A National Network of the Alliances of Women Councilors of Albania has been established in support of gender equality and the empowerment of women in decision-making processes. This network

is composed of 18 alliances from different municipalities, representing over half of the country's population. UN Women, with funding from the Swedish government, has provided technical support in establishing and strengthening eight alliances. **Women's equal participation in the political and public life is a human right.**



Gentiana Sinjari është njëra prej 471 fermereve në Shqipëri që ka përfituar nga skemat e subvencioneve të Ministrisë së Bujqësisë. Investimet me ndjeshmëri gjinore po zbatohen nga ministritë ndërsa planifikojnë programet e tyre buxhetore afatmesme, me ndihmesën e UN Women dhe me financimin e Agjencisë Austriake për Zhvillim. 32 nga 84 programet buxhetore nga 11 ministri përfshijnë buxhetim të përgjegjshëm gjinor në planet

e tyre buxhetore 2019-2021. Parashikohet që buxheti në mbështetje të politikave me bazë gjinore për vitin 2019 të jetë në vlerën totale të 297 milionë USD. Bujqësia punëson më shumë se gjysmën e grave në Shqipëri. Megjithatë, ende nuk ka masa efikase në dhënien e huave me interesa lehtësuese për gratë e zonave rurale, dhe atyre u mungon mbështetja për të nisur sipërmarrjet e tyre. Gratë duhet të kenë të drejta të barabarta për t'u punësuar.

Gentiana Sinjari is one of the 471 women farmers in Albania who benefited from the subsidy scheme of the Ministry of Agriculture. Gender-sensitive investments are being implemented by Ministries as they plan their mid-term budget programs, assisted by UN Women with funding from the Austrian Development Agency. 32 out of 84 budget programs from 11 ministries include

gender responsive budgeting in the 2019-2021 budget plans. In total 297 Million USD is foreseen in the 2019 budget to support gender-based policies. Agriculture employs more than half of women in Albania. Still, there are no effective measures in favor of facilitating loans for rural women and they lack support to start their own businesses. Women should have equal right to employment.

GENTIANA

Jeta, një vajzë 23 vjeçare nga Lezha, u martua në moshën 16 vjeçare me burrin që donte. Gjithçka dukej në rregull për çiftin e ri deri në momentin që ajo mbeti shtatzënë. “Kur morëm lajmin që ne po prisnim një vajzë, ai u tërbua. Ai më la të vetme në spital”. Kur Jeta refuzoi të abortonte foshnjën, bashkëshorti i saj u bë menjëherë i dhunshëm. Për vite me radhë ajo vuajti abuzim të rëndë deri në ditën që nuk duroi më. Për t’i shpëtuar dhunës, ajo shkoi në rajonin e policisë së bashku me vajzën e saj. Departamenti i policisë njoftoi “Shtëpinë e Ngjyrave”, një

JETESA NË NJË AMBIENT PA DHUNË ËSHTË NJË E DREJTË E NJERIUT

qendër emergjencash e kujdesit ditor dhe mbrojtjes së fëmijëve, e administruar nga organizata lokale ARSIS. Qendra është themeluar me anë të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian, në bashkëpunim me UNICEF dhe Bashkinë e Tiranës. Jeta mori strehim, këshillim psikologjik dhe ndihmë ligjore falas nga organizata ARSIS. “Nuk e di se ku do të isha pa ndihmën e policisë, ARSIS dhe Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve. U ndjeva shumë e mbrojtur dhe mora mbështetjen aq të nevojshme emocionale”. Jeta tani ka një punë dhe ajo mund të paguajë qiranë e shtëpisë së saj. Vajza e saj shkon në kopsht. Jeta dhe vajza e saj po jetojnë më në fund një jetë pa dhunë. Jetesa në një ambient pa dhunë është një e drejtë e njeriut.



JETA

Jeta a 23 years old from Lezha was married at 16 to the man she loved.

Everything seemed all right for the new couple until the start of her pregnancy. “When we got the news that we were expecting a girl he became furious. He left me alone in the hospital”. When Jeta refused to have an abortion her husband quickly turned violent. For years she suffered severe abuse until one day she had enough. To escape

from the violence, she went to the police station with her daughter. The police department contacted “The House of Colors”, a day care and child protection emergency center managed by the local organization ARSIS. The center is established with financial support from European Union, in collaboration with UNICEF and the Municipality of Tirana. Through ARSIS, Jeta received shelter, physiological counselling and free legal

**LIVING IS A
VIOLENCE FREE
ENVIRONMENT IS A
HUMAN RIGHT**

aid. “I don’t know where I would have been without the help of the police, ARSIS and Child protection Unit. I felt very protected and received the much-needed emotional support”. Jeta now has a job and she manages to pay the rent of her house. Her daughter attends kindergarten. Jeta and her daughter are finally living a life free from violence. **Living is a violence free environment is a human right.**

Ejona Cania, është një punonjëse krenare për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë e Peshkopisë. Ajo përfundoi studimet në degën e Psikologjisë në Universitetin e Tiranës, por në ndryshim nga shoqëria e saj e cila vendosi të qëndrojë në kryeqytet, Ejona u kthye sërish në fshatin e saj për t'u bërë një punonjëse sociale. "Gjithnjë kam dashur të punoj me fëmijët dhe të ndihmojë fëmijët në nevojë" - thotë Ejona. Në vitin 2017, Ejona trajtoi 21 raste të fëmijëve në rrezik abuzimi. Edhe pse janë më shumë se 3000 fëmijë në fshatin e saj, Ejona është e vetmja punonjëse për mbrojtjen e fëmijëve. Pa buxhet, pa strehë emergjence apo pa asnjë mbështetje tjetër, bashkia mbështetet vetëm në ndihmën e organizatave joqeveritare. Ajo çfarë e bën Ejonën të jetë më optimiste është fakti se bashkia po përgatit tashmë një plan të ri social për të forcuar mekanizmin mbrojtës, njerëzit në fshatin e saj po bëhen përherë e më të ndërgjegjshëm për të drejtat e fëmijëve të tyre dhe bëjnë përgjegjëse qeverinë për mungesën e shërbimeve. Këto përmirësime janë rezultat i punës dhe advokimit të Ejonës. Edhe vetëm një person mund ta bëjë ndryshimin në shoqëri. Të drejtat e fëmijëve janë të drejtat e njeriut.

Ejona Cania, is a proud Child Protection Worker at the municipality of Peshkopi. She graduated with a degree in Psychology from the University of Tirana, but unlike her friends who decided to stay in the capital Tirana, Ejona went back to her village to become a social worker. "I have always wanted to work with children and help children in need"--says Ejona. In 2017 Ejona handled 21 cases of children at risk of abuse. Although there are more than 3000 children in her village, Ejona is the only child protection worker. With no available budget, no emergency shelters, or any other support, the Municipality only relies on the help of non-governmental organization. What makes Ejona more optimistic is the fact that the municipality is currently preparing a new social plan aiming to strengthen protection mechanism, people in her town are becoming more aware of their children's rights and are holding the government to account for lack of services. These improvements are the result of Ejona's work and advocacy. Even one person can make a difference in society. Children's rights are human rights.

TË DREJTAT E FËMIJËVE JANË TË DREJTAT E NJERIUT.

CHILDREN'S RIGHTS ARE HUMAN RIGHTS.



QASJA NË INFORMACION ËSHTË NJË E DREJTË E NJERIUT

Ermal Hallaci është një alpinist që jeton në një fshat të largët të Kukësit. Me një interes në turizëm, Ermali ka udhëtuar shpeshherë në qytetin e Kukësit për t'u përditësuar me vendimet dhe projektet e bashkisë që ndikojnë në këtë sektor. Udhëtimet vajtje-ardhje i kanë kushtuar kohë dhe para. Tani ai nuk ka nevojë ta kryejë më këtë gjë. Si

pjesë e Projektit të Konsolidimit të Reformës Administrative dhe Territoriale të PNUD, Ermali tanimë ka qasje në publikimet online të vendimeve të Këshillave Bashkiakë. 34 njësi administrative të Kukësit kanë nisur procesin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe rritjen e transparencës për qytetarët. Qasja në informacion është një e drejtë e njeriut.

Ermal Hallaci is an alpinist living in a remote village of Kukes. With an interest in tourism, Ermal has frequently travelled to the city of Kukes to stay up to date on municipality decisions and projects impacting this sector. Travelling back and forth has cost him both time and money. Now he does not need to do that. As part of

UNDP supported Consolidation of Administrative Territorial Reform Project, Ermal can now access the online publication of Municipality Councils decisions. 34 municipalities in Kukes are currently on their way to implement the law on the Right to Information and Increasing Transparency for citizens. Access to information is a human right.

ERMAL

ACCESS TO INFORMATION IS A HUMAN RIGHT

Elvira, e martuar me një fëmijë, u fejuanë moshën 18 vjeçare dhe u martua në moshën 22 vjeçare.

Ajo shpresoi për një të ardhme të lumtur me bashkëshortin e saj por kjo lumturi nuk erdhi kurrë, edhe pasi çifti mori lajmin e mrekullueshëm të ardhjes së fëmijës së tyre të parë. Elvira vuajti dhunë të rëndë nga bashkëshorti i saj. Një ditë, ajo mësoi për mekanizmin e reagimit të koordinuar të komunitetit (RKK). Shumë shpejt Elvira mori mbështetje ligjore falas, këshillim psikologjik për të dhe fëmijën e saj dhe paketa ushqimore nga bashkia të shpërndara në mënyrë specifike në mbështetje të grave dhe vajzave që vuajnë nga dhuna në familje. Me anë të kësaj ndihme, Elvira arriti të rindërtojë jetën e saj larg nga abuzuesi; djali i saj shkon rregullisht në shkollë dhe po rritet në një shtëpi të sigurt e pa dhunë. Elvira po vijon me ndjekjen e procedurave ligjore për të paditur abuzuesin e saj dhe po përfaqësohet në seancat gjyqësore nga avokat, pa pagesë. Në Shqipëri, një në dy gra kanë deklaruar se kanë qenë viktimë e abuzimit psikologjik apo fizik. Ky është një dhunim i rëndë i të drejtave të njeriut. Me partnerët tanë, qeverinë suedeze, punojmë për të krijuar një mjedis mundësues ku gratë të mund të rimëkëmben. Jeta pa dhunë është një e drejtë e njeriut.

Elvira married with one child, got engaged at 18 and was married at 22.

She hoped for a happy future with her husband, but that happiness never arrived, even after the couple received the wonderful news of having their first child. Elvira suffered severe violence by her husband. One day, she learned about the coordinated community response mechanism (CCR). Soon Elvira received free legal aid support, psychological counselling for her and children and food packages from the municipality distributed specifically in support of women and girls suffering from domestic violence. With this assistance, Elvira has managed to rebuild her life far away from her abuser; her son attends school regularly and is being brought up in a safe home without violence. Elvira is still following the legal procedures to sue her abuser and is represented in court hearings with free of charge attorneys. In Albania one in two women have declared to be the victims of psychological or physical abuse. This is a severe violation of human rights. With our partners, Government of Sweden we work to create an enabling environment for women to thrive. Living without violence is a human right.

**JETA PA DHUNË
ËSHTË NJË E
DREJTË E NJERIUT**

**LIVING WITHOUT
VIOLENCE IS A
HUMAN RIGHT**

ELVIRA

ERMIRA

Ermira Domi është e divorcuar dhe me dy fëmijë.

Ish-burri i saj abuzonte fizikisht dhe psikologjikisht me të dhe fëmijët e saj: "ai nuk sillte bukë në shtëpi, ai kurrë nuk kujdesej për fëmijët." Ajo kurrë nuk lejohet të dilte nga shtëpia, - ajo nuk kishte liri. Pas vitesh të tëra në vuajtje, Ermira më në fund vendosi t'i jepte fund dhunës së vazhdueshme duke kërkuar ndihmë në një strehë për viktimat e dhunës në familje. Në strehë, ajo dhe fëmijët saj morën shërbime shëndetësore që përfshinin përkujdesje fizike, mendore dhe mjekësore. Ajo gjithashtu ka përfituar nga skema e bashkisë për banesat sociale. Falë strehës, tashmë Ermira ka nisur një jetë të re bashkë me dy fëmijët e saj. Jeta pa dhunë është një e drejtë e njeriut.

PNUD mbështet krijimin dhe konsolidimin e mekanizmeve të përgjigjes institucionale në nivel bashkiak, me qëllim dhënien e mbështetjes ndaj shërbimeve të integruara shumë-sektoriale për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Duhet vendosur mekanizma për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur dhunës me bazë gjinore në mënyrë që të garantohen të drejtat themelore të grave dhe vajzave.

Ermira Domi is divorced with two children.

Her ex-husband abused her and her children both physically and psychologically: "he would not bring food home, he would never take care of the children." She was never allowed to leave the house, - she had no freedom. After years of suffering Ermira finally decided to put an end to the ongoing violence by seeking help in a shelter for victims of domestic abuse. In the shelter she and her children received health services including both physical, mental and medical care. She has also benefited from the municipality social housing scheme. Thanks to the shelter, Ermira has now started a new life with her two children. Living without violence is a human right.

UNDP supports the establishment and consolidation of institutional response mechanisms at municipal level, aiming at providing support to multi-sectorial integrated services to gender-based violence victims. To ensure the fundamental rights of women and girls mechanisms must be in place to help prevent and respond to gender-based violence.

TË GJITHË NJERËZIT KANË LINDUR TË LIRË DHE TË BARABARTË. QASJA NË PUNËSIM TË DENJË ËSHTË NJË E DREJTË E NJERIUT.

Matilda Daja, një vajzë 27 vjeçare që vjen nga komuniteti egjiptian, ëndërronte që një ditë të kishte sallonin e saj të flokëve. Megjithatë, si shumë vajza të tjera në komunitetin e saj, ajo e la shkollën pas klasës së 8-të, u martua dhe u bë nënë në një moshë shumë të vogël. Matilda u përpoq shumë të gjente një punë dhe të kishte të ardhura të qëndrueshme, por pa arsimin dhe përvojën e duhur kjo gjë ishte praktikisht e pamundur. Në partneritet me BE, PNUD mbështet komunitetet romë dhe egjiptiane në Shqipëri për të thyer rrethin vicioz të papunësisë duke zhvilluar programe të posaçme që nxisin punësimin. Matildës iu ofrua një mundësi punësimi në një qendër bukurie nëpërmjet skemës së "formimit në vendin e punës". Për gjashtë muaj Matilda u trajnuar dhe mori aftësitë e nevojshme. Ajo gjithashtu përfitoi nga skema e granteve të vogla që i mundësuan hapjen e qendrës së saj të bukurisë. Të gjithë njerëzit kanë lindur të lirë dhe të barabartë. Qasja në punësim të denjë është një e drejtë e njeriut.

Matilda Daja, a 27-year-old girl coming from the Egyptian community, dreamed of having her own hair salon one day. However, like many other girls in her community she left school after 8th grade, got married and became a mother at a very young age. Matilda tried hard to find a job and have stable earnings, but without education and work experience this proved to be impossible. In partnership with the EU, UNDP supports Roma and Egyptian communities in Albania to break the vicious unemployment cycle by developing tailor-made employment promotion programmes. Matilda was offered an employment opportunity at a beauty center through the "on-the-job" training scheme. For six months Matilda was trained and acquired the necessary skills. She also benefited from small grants scheme that enabled her to open her own beauty center. **All people are born free and equal. Having access to decent employment is a human right.**

**ALL PEOPLE ARE
BORN FREE AND
EQUAL. HAVING
ACCESS TO DECENT
EMPLOYMENT IS A
HUMAN RIGHT.**

MATILDA



Ilir Muhaxhiri dhe familja e tij kanë qenë “ligjërish të padukshëm” për më shumë se 30 vite. Edhe pse kanë jetuar në Shkodër për pjesën më të madhe të jetës së tyre, familja është regjistruar si rezidente në këtë rajon vetëm kohët e fundit. Mungesa e dokumenteve personale përjetëson marginalizimin e komunitetit rom. PNUD, në bashkëpunim me BE dhe partnerët lokalë, shqyrtojnë

zgjidhje të problemeve me të cilat komuniteti rom përballet në trajtimin e çështjeve të regjistrimit civil. Iliri u regjistrua si një qytetar i Shkodrës në nëntor 2017, duke i dhënë mundësi atij dhe familjes së tij të kishte qasje të ndihma sociale, kartat dhe shërbimet e shëndetit tek të cilat nuk kishin qasje më parë. Regjistrimi civil dhe identifikimi personal janë mjaft të rëndësishme

për garantimin e të drejtave themelore të komunitetit rom. Në procesin e regjistrimit civil janë mbështetur 300 persona, të cilët gjithashtu kanë përfituar një qasje të përmirësuar në shërbimet bazë që prej vitit 2016. Regjistrimi civil është mjaft i rëndësishëm për realizimin e të drejtave të njeriut dhe themelor për garantimin e një shoqërie që funksionon në mënyrën e duhur.

Ilir Muhaxhiri and his family have been “legally invisible” for over 30 years. Although they have been living in Shkodra for most of their lives, the family was only recently registered as residents of this region. The lack of personal documents perpetuates the marginalization of Roma. In cooperation with EU and

local partners, UNDP explores solutions to the problems Roma face in addressing civil registration. Ilir registered as a citizen of Shkodra in November 2017 enabling him and his family access social assistance, health cards and services, which they were not entitled to before. Civil registration and personal

identification is crucial for ensuring Roma’s fundamental rights. Around 300 individuals are supported with civil registration and have enjoyed improved access to basic services since 2016. Civil registration is crucial for the realization of human rights and fundamental for ensuring a well-functioning society.





Mimoza Bardhi është 27 vjeç dhe nënë e tre fëmijëve. Prindërit e saj u ndanë dhe familja u përball me vështirësi të mëdha ekonomike. Mimoza kurrë nuk shkoi në shkollë. Tani, si një e rritur me përgjegjësi prindërore, ajo ndjen keqardhje që nuk e kishte kuptuar më parë rëndësinë e arsimit. E vendosur për të mësuar se si të shkruajë e të lexojë, për të ndihmuar më mirë fëmijët e saj në detyrat e tyre të shkollës, ajo kreu një kurs të leximit bazë dhe aftësive jetësore me një program mësimor të zhvilluar për të rriturit. Në saj të programit, Mimoza Bardhi po merr më në fund përvojën shkollërore që i ishte privuar kur ishte një vajzë e vogël. Kursi është përgatitur për të mbështetur arsimimin e grupeve vulnerabël. Arsimimi është një e drejtë themelore e njeriut, thelbësor për përparimin e shoqërisë. Më shumë se 111 persona nga komuniteti rom dhe egjiptian morën pjesë në kursin e leximit bazë dhe aftësive jetësore, të organizuar mes viteve 2017-2018. Në Shqipëri, komunitetet rom dhe egjiptian janë ndër grupet më të varfër, të marginalizuar dhe të përjashtuar nga shoqëria. Me ndihmën e BE-së, PNUD ka për qëllim të rrisë përfshirjen e këtyre komuniteteve, nëpërmjet projektit "Fuqizimi ekonomik dhe social i romëve dhe egjiptianëve – një shtysë për përfshirjen sociale".



Mimoza Bardhi is 27 years old and a mother of three. Her parents were divorced, and the family faced severe economic hardships. Mimoza never went to school. Now, as an adult with parenting responsibilities, she regrets not to have understood the importance of education sooner. Determined to learn how to write and read to better help her children with school work, she completed

a basic literacy and life skills course with a curriculum developed for adults. Thanks to the programme, Mimoza Bardhi is finally having the school experience she deprived herself of as a young girl. The course is designed to support the education of vulnerable groups. **Education is a fundamental human right, essential for the advancement of society.** More than 111 Roma and Egyptian participated

in the basic literacy and life skills course, organized between 2017-2018. Roma and Egyptians are amongst the poorest, most marginalized and socially excluded groups in Albania. With support from the EU, UNDP aims to enhance the inclusion of these communities, through the 'Economic and Social Empowerment for Roma and Egyptians - a booster for social inclusion' project.

Renato është një djalë 9 vjeçar i diagnostikuar me çrregullim të spektrit të autizmit. Kur ai mbërriti për herë të parë në qendrën e zhvillimit në Sarandë një vit më parë, ai kishte vështirësi në të folur, në krijimin e marrëdhënieve me moshatarët e tij dhe preferonte të qëndronte i vetëm. Ai mori terapi në grup dhe në mënyrë individuale, gjë e cila e ndihmoi të ndryshonte ndjeshëm sjelljen e tij. Sot ai është më social dhe i pëlqen të ndërveprojë me të tjerët. Renato është njëri prej 25 fëmijëve që merr shërbime aftësimi dhe rehabilitimi në Qendrën e Zhvillimit Sarandë. Në total, qendra i ofron shërbime 50 fëmijëve me aftësi të kufizuara. Njerëzit me aftësi të kufizuara janë përgjithësisht ata më të lënë pas dore në Shqipëri. Kombet e Bashkuara punojnë për të siguruar se të gjitha qeniet njerëzore gëzojnë të drejtat e njeriut.

Në Sarandë është ngritur një Qendër Zhvillimi e cila ofron shërbime aftësimi dhe rehabilitimi.

Renato is a 9-year-old boy diagnosed with autism spectrum disorder. When he first arrived at the development center of Saranda a year ago, he struggled to speak, build relations with his peers and preferred to stay by himself. He received group and individual therapy which helped change his behavior dramatically. Today he is more social and likes interacting with others. Renato is one of 25 children who receives habilitation and rehabilitation services at the Saranda Development Center. In total, the center provides services to 50 children with disabilities. People with disabilities are often those most left behind in Albania. UN works to ensure that all human beings enjoy human rights.

In Saranda, a development Center has been established which provides habilitation and rehabilitation services?



GJITHKUSH KA TË DREJTË TË LARGOHET NGA CILIDO VEND QOFTË, PËRFSHIRË KËTU EDHE TË VETIN, SI DHE TË KTHEHET NË VENDIN E VET

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT: NENI 13

Nelsi u mundua të përmbushte ëndrrën e tij për t'u zhvendosur në Kanada pak vite më parë. Për të përballuar udhëtimin, ai vendosi të shiste një pjesë nga bagëtitë e familjes së tij. Megjithatë, ëndrra e tij shpejt u kthye në një makth, sepse Nelsi nuk kishte ndjekur procedurat e duhura ligjore. Kur u pikas, ai u dërgua në qendrat e paraburgimit për disa muaj. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit ja mbaruan paratë që kishte në dispozicion. Në një gjendje të dëshpëruar, Nelsi vendosi të kthehej vullnetarisht në shtëpi. Ai u pranua në një skemë të riintegrimi thelbësor mbështetur nga IOM. Pas disa javëve këshillimi me familjen e tij dhe personelin e IOM, ai vendosi ta përdorte grantin për të blerë një traktor për të rritur prodhimtarinë e tokës e kështu të ardhurat e familjes. Nelsi nuk pendohet që është kthyer në shtëpi. Me marrjen e ndihmës së duhur, tani ai po ecën përpara. Rikthimi në mënyrë të sigurt në vendin tënd është një e drejtë e njeriut.



Nelsi tried to achieve his dream of moving to Canada a few years ago. To afford the journey, he decided to sell part of his family's cattle. However, his dream quickly turned into a nightmare, as Nelsi had failed to follow the necessary legal procedures. When detected, he was sent to a detention center for several months. All the travel costs exhausted his budget completely. In a desperate state, Nelsi decided to return home voluntarily. He became eligible to a substantial reintegration support scheme supported by IOM. Following weeks of consultations with his family and IOM staff, he decided to use the grant to purchase a tractor to improve land productivity and increase family income. Nelsi does not regret having returned home. With the right assistance he is forging ahead. **Safe return to one's home country is a human right.**

**EVERYONE HAS
THE RIGHT TO
LEAVE ANY
COUNTRY,
INCLUDING HIS
OWN, AND TO
RETURN TO HIS
COUNTRY**

UNIVERSAL DECLARATION ON HUMAN RIGHTS
ARTICLE 13.

Përvoja e emigracionit e Ilirit në Norvegji ishte e shkurtër dhe nuk ishte ashtu siç ai e kishte pritur. I mbetur pa asnjë shpresë se statusi i tij i emigrantit do të legalizohej, ai vendosi të kthehej në shtëpi në mënyrë vullnetare. IOM i ofroi Ilirit seanca këshillimore se si të përdorte grantin për riintegrim si dhe mbështetjen për qasjen ndaj mundësive të investimit

nëpërmjet marrjes së granteve. Iliri dhe familja e tij vendosën t'i investojnë paratë e tyre në një kafene të vogël në fshatin e tyre. Të ardhurat e nxjerra nga kjo veprimtari po e ndihmojnë tashmë Ilirin dhe familjen e tij për të pasur një jetë të denjë. Vajtja dhe rikthimi në mënyrë të sigurt në vendin tënd është një e drejtë e njeriut.



Ilir's migration experience to Norway was short and not as he had expected. Left with no hope of legalizing his migrant status, he decided to return home voluntarily. IOM provided counselling sessions to Ilir on how to use the reintegration grant as well as assistance on viable grant investment

opportunities. Ilir and his family decided to invest their money into a small coffee bar in his village. The income generated from the activity is now helping Ilir and his family live a decent life. **Leaving and returning safely to one's home country is a human right.**



GJITHKUSH KA TË DREJTË TË KËRKOJË DHE GËZUJË NË VENDE TË TJERA AZIL NGA PERSEKUTIMI.

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT: NENI 14

EVERYONE HAS THE RIGHT TO SEEK AND TO ENJOY IN OTHER COUNTRIES ASYLUM FROM PERSECUTION.

UNIVERSAL DECLARATION ON HUMAN RIGHTS, ARTICLE 14

Majlinda ëndërronte të krijonte një jetë të re në Norvegji. Pasi kërkesa e saj për azil u refuzua, ajo vendosi të kthehej në shtëpi nëpërmjet procesit të kthimit dhe riintegrimit të IOM. Majlinda mori trajnim, i cili i dha asaj aftësitë kryesore në biznesin e bukë-pjekjes. Fal aftësive që ajo mori, tani Majlinda punon dhe bën një jetë të denjë. Programi riintegrues gjithashtu i dha mbështetje fëmijëve të saj, duke i mundësuar kështu qëndrimin në shkollë. Kërkesa për azil për shkak të persekutimit është një e drejtë e njeriut.

KËRKESA PËR AZIL PËR SHKAK TË PERSEKUTIMIT ËSHTË NJË E DREJTË E NJERIUT.

Majlinda dreamt of establishing a new life in Norway. After her asylum claim was rejected, she decided to return home through the IOM return and reintegration process. Majlinda received training which provided her with essential skills in the bakery business. Thanks to the skills she acquired she now works and earns a decent living. The reintegration program also provided support to her children which enabled them to stay in school. **Seeking asylum from persecution is a human right.**

SEEKING ASYLUM FROM PERSECUTION IS A HUMAN RIGHT.



MAJLINDA

Indriti është një djalë 8 vjeçar nga komuniteti rom, i lindur nga një marrëdhënie jashtëmartesore. Mamaja ishte familja e tij e vetme. Ajo e kishte të pamundur për t'u përkujdesur për të për shkak të aftësive të saj tejet të kufizuara. Indriti u braktis nga mamaja e tij biologjike. Një çift rom me dy vajza filloi të kujdesej për Indritin dhe gradualisht filloi ta donte dhe të përkujdesej për të. Ata e donin Indritin në jetën e tyre. Ata kontaktuan, me sukses, një organizatë të shoqërisë civile që jepte ndihmë ligjore falas për personat në nevojë, për të kërkuar kujdestari të plotë për Indritin. Prindërit adoptues thanë:

“Kur dëgjuam për qendrën e ndihmës ligjore falas në gjykatën e rrethit Fier, ne nuk arrinim ta besonim këtë gjë. Ne e kuptuam që kjo gjë ishte e vërtetë vetëm kur u takuam me avokatin mbrojtës. Ishte një shërbim i madh për njerëzit si ne”.

Tani Indriti ka një familje që mund të përkujdeset për të. Ai shkon në shkollë dhe gëzon të tjera të drejta që i takojnë. Me anë të mbështetjes së PNUD, katër qendra të ndihmës ligjore janë ngritur në katër gjykata rrethi anembanë Shqipërisë. Në vit, gati 1500 persona kanë marrë shërbimet e ndihmës së parë ligjore falas, duke i ardhur në ndihmë sidomos personave më në nevojë. Qasja në ndihmën ligjore është një e drejtë e njeriut

Indrit is an 8-year-old boy from the Roma community born out of an extramarital relationship. His mother was his only family. She was unable to take care of him due to her severe disability. Indrit was abandoned by his biological mother. A Roma couple with two daughters began to look after Indrit and gradually came to love and care for him. They wanted him in their lives. They successfully contacted a civil society organization that provides free legal aid to vulnerable people, to seek full custody of Indrit. The adoptive parents said:

“When we heard about the free legal aid centre in Fier district court, we could hardly believe it. We only realized this was true when we met with the defence lawyer. It is a great service to people like us”.

Now, Indrit has a family that can take care of him. He goes to school and enjoys other basic rights he is entitled to. With UNDP assistance, four legal aid centres are established in district court offices across Albania. Around 1500 people annually received primary free legal aid services benefitting those most in need. Access to legal aid is a human right

Now, Indrit has a family that can take care of him. He goes to school and enjoys other basic rights he is entitled to. With UNDP assistance, four legal aid centres are established in district court offices across Albania. Around 1500 people annually received primary free legal aid services benefitting those most in need. Access to legal aid is a human right

**QASJA NË NDIHMËN
LIGJORE ËSHTË NJË E
DREJTË E NJERIUT.** **ACCESS TO LEGAL
AID IS A HUMAN
RIGHT.**



INDRIT

Mariona Zhuri, 24 vjeç, është njëra prej finalisteve të projektit të vetëpunësimit të drejtuar nga PNUD. “Gjatë kohës sime si studente, shpeshherë isha e detyruar të merrja autobusin e të shkoja në qytet sepse nuk kisha librari pranë. Nuk mund të gjeja vend ku të printoja, përdorja internetin apo blija materiale shkollore. Ideja ime e biznesit lindi nga përvoja ime personale.” Mariona po kërkonte për një punë me kohë të pjeshme kur ndeshi me informacionin për Programin e vetëpunësimit, ku

mbështeteshin dhe financoheshin ide të qëndrueshme biznesi. “Pas marrjes së trajnimit intensiv, pash se si ideja ime u bë më e fortë dhe më e strukturuar. Në momentin që përfitova grantin, mora me qira një dyqan të vogël në afërsi të një shkolle të mesme dhe fillova ta rinovoj e mobiloj.” Sot, ajo administron biznesin e saj të suksesshëm, një librari e orientuar drejt teknologjisë së informacionit, e vendosur në periferi të Tiranës. Qasja në punësim të denjë është një e drejtë e njeriut.

QASJA NË PUNËSIM TË DENJË ËSHTË NJË E DREJTË E NJERIUT.



Mariona Zhuri, 24 years old, is one of the finalists of the UNDP led Self-employment project. “During my time as a student, I was often forced to take the bus to the city because there were no bookstores nearby. Nor could I find a place to print, use the internet, or buy school materials. My business idea was born from my personal experience.” Mariona was looking for a part-time job when she came across the information on the Self-employment Programme, where sustainable business ideas would get supported and funded. “Following the intensive training, I saw how my initial idea grew both stronger and more mature. Once I received the grant, I rented a small shop next to the local high-school and started to renovate and furnish. Today, she manages her own successful business, an IT-oriented bookstore located in the outskirts of Tirana. **Having access to decent employment is a human right.**”

HAVING ACCESS TO DECENT EMPLOYMENT IS A HUMAN RIGHT.

Erjon Tusha, 25 vjeç, është një tjetër sipërmarrës i ri që mori mbështetje në formën e trajnimeve dhe granteve nga Programi i vetëpunësimit.

Ideja e tij e biznesit lindi gjatë një udhëtimi në Vjenë. "Një natë u zgjova i sëmurë në një dhomë hoteli dhe kisha nevojë të gjeja një farmaci pa ditur se ku mund ta gjeja atë. Ishte ky moment që më lindi ideja, që më pas do të bëhej

biznesi im, pra një aplikacion për celular që shfaq vendndodhjen e farmacive dhe shërbimeve mjekësore përreth vendndodhjes së përdoruesit. Programi i vetëpunësimit më mbështeti në avancimin nga një punonjës i pavarur në pasjen e kompanisë time të strukturuar të teknologjisë së informacionit. Qasja në punësim të denjë është një e drejtë themelore e njeriut.

Erjon Tusha, 25 year old, is another young entrepreneur who got support in the form of training and grants from the Self-employment Programme. His business idea kicked in during a trip to Vienna. "One night I woke up sick in a hotel room and needed to find a pharmacy having no idea where to find one. This was the moment where I got

the idea that would later lead to my business, a mobile app offering the location of pharmacies and medical services around one user's location. The Self-employment Programme supported me in advancing from being a freelancer to having my own structured IT- company. **Having access to decent employment is a basic human right.**

ERJON



Luli Feri, është një anëtare e komunitetit egjiptian.

Ajo është përballur me diskriminim gjatë gjithë jetës së saj për shkak të ngjyrës së saj të lëkurës. “Këtë gjë e ndjeva që në ditën e parë të shkollës. Askush nuk donte të ulej pranë meje. E lashë shkollën pak më pas. Prindërit e mi ishin të lumtur me vendimin që kisha marrë. Sot, ende i ndjej pasojat e këtij veprimi. Është shumë e vështirë gjetja e një pune pa pasur aftësitë dhe arsimimin e duhur. Për vite me radhë jam regjistruar në zyrat e punësimit si një punëkërkuese e papunë. Askush nuk më ka ofruar kurrë një punë”.

Ajo kujton: “Çdo mëngjes, shihja njerëz të veshur mirë që shkonin për në punë, ndërsa unë mundohesha shumë të mbledhja qindarka nga puna ime rraskapitëse dhe joformale e mbledhjes së materialeve të riciklueshme në kazanët e Tiranës. Për vite me radhë, duhet të duroja shikimin e tmerrshëm që më hidhnin njerëzit ndërsa unë boshatisja kazanët për të gjetur atë që po kërkoja. Familja ime mezi mbijetonte me ato pak para që fitoja. Një ditë, takova një ndërmjetëse punësimi i cili po koordinonte programin e punësimit për komunitetin rom dhe egjiptian. Ajo më pyeti nëse isha e interesuar për të pasur një punë të rregullt me një kompani ndërkombëtare riciklimi që bashkëpunon me Bashkinë e Tiranës për të formalizuar biznesin e riciklimit. Kur mora vesh për përfitimet, thash menjëherë po.”

“Kompania më trajnoi lidhur me etikën e punës, metodën e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve dhe të tjera çështje të lidhura me punën. Sot punoj për “Eco Tirana”. Kjo është puna ime e parë e rregullt dhe me kohë të plotë që kam pasur. Kompania më paguan sigurimet shoqërore. Kam një uniformë. Shkoj në punë në orën 6 të mëngjesit



LULI

dhe në shtëpi në orën 4 pasdite. Rrogën e marr çdo muaj. Kurrë nuk kam guxuar ta ëndërroj këtë gjë.”

“Në fillim e kisha të vështirë të mësohesha me idenë që duhet ta merrja rrogën çdo muaj sepse isha mësuar të fitoja pak para çdo ditë. Gjithsesi rroga që marr tani është më e mirë seç fitoja vetë. Punoj fort që të përmbush pritshmëritë e punëdhënësit. Muajin e kaluar mora

një shpërblim për punën e mirë. Por më e rëndësishmja është që ndjehem e respektuar në vendin tim të punës. Edhe pse nuk kam pasur një jetë të lehtë, jam krenare për veten sepse jetova me dinjitet. I kam rritur e mësuar pesë fëmijët e mi që të jenë të ndershëm. Kjo është mënyra ime sesi sfidoj qëndrimet diskriminuese. Kjo është përgjigja për njerëzit që na shohin me përbufje.” Qasja në punësim është një e drejtë e njeriut.

Luli Feri, is a member of the Egyptian community.

All her life she has faced discrimination due to the color of her skin. “I felt it from my first day at school. Nobody wanted to sit next to me. I left school soon after. My parents were happy with my decision. Today, I still feel the consequences of this. Without skills and education finding a job is difficult. For years, I have been registered at the employment

office as unemployed job seeker. Nobody has ever offered me a job”.

She recalls; “Every morning I would watch well-dressed people going to work, while I was trying hard to earn pennies through exhausting, informal work of collecting recycling materials in the trash bins of Tirana. For years, I have had to stand the terrible looks of people while I have been emptying

trash bins to find what I was looking for. My family could hardly survive with the little money I earned. One day, I met an employment mediator who was coordinating an employment programme for Roma and Egyptians. She asked me if I was interested to have a regular job with an international recycling company which has partnered with Tirana Municipality to formalize the recycling business. When I heard of the benefits, immediately I said yes.”

“The company trained me on job ethics, methods to collect and transport waste and other job-related issues. Today I work at Eco Tirana. It’s the first regular and full-time job I have ever had. The company pays my social insurance. I have a uniform. I go to work at 6 am and go home at 4 pm. I get a salary every month. I never dared dream of this.”

“In the beginning it was very difficult to get used to the idea that I had to get my salary once a month since, I was used to earning little very day. Still, the salary I get now is much better than what I earned on my own. I work hard to meet employers’ expectations. Last month I received a bonus for a job well done. Most importantly I feel respected at the work place. Although I have not had an easy life, I’m proud of myself because I have lived with dignity. I have raised and taught my five children to be honest. **This is how I challenge discriminatory attitudes. This is my answer to people who look down on us.” Access to employment is a human right.**

E. D, çdo mëngjes bën gati çantën dhe largohet nga dhoma e tij në pavionin e pacientëve të shtruar në Qendrën Universitare Mjekësore “Nënë Tereza” në Tiranë. 27 vjeçari është diagnostikuar me kancer në tru në vitin 2016. Pas trajtimeve të pasuksesshme në vendlindjen e tij, Berat, ai u transferua në spitalin “Nënë Tereza” këtë verë ku po merr radioterapi me një akselerator të ri linear, të blerë me mbështetjen e IAEA. “Ndërhyrja kirurgjikale që kreu në vendlindjen time ma bëri të pamundur të lëvizja dorën time të djathtë dhe këmbën e majtë. Radioterapia me makinerinë e re, më ka ndihmuar shumë. Edhe vetëm pas një muaji këtu, po ndjehem shumë më mirë, e tani mund të lëviz dorën time e të eci sërish,” tha E.D. IAEA po ndihmon qeverinë shqiptare për të trajtuar pacientët me kancer dhe ka mbështetur vendosjen e makinerisë më të fundit të akseleratorit linear. Çdo vit në Shqipëri, raportohen rreth 7000 raste kanceri. Është llogaritur se të paktën 50% e tyre kanë nevojë për trajtim me radioterapi, që tashmë mund ta marrin vetëm në Spitalin Nënë Tereza. Pas instalimit të makinerive të reja, tani spitali ka kapacitet të trajtojë rreth 1350 raste në vit, e cila ka ulur listën e pritjes nga tre muaj në tre javë. Qasja në trajtim mjekësor është një e drejtë e njeriut.

E. D packs his bag every morning and leaves his room in the in-patient wing of the University Medical Center ‘Mother Teresa’ in Tirana. The 27-year old was diagnosed with brain cancer in 2016. After unsuccessful treatments in his hometown of Berat, he was transferred to ‘Mother Teresa’ hospital this summer where he is now receiving radiotherapy with a brand new linear accelerator, acquired with the support of the IAEA. “The surgery I undertook in my hometown left me unable to move my right hand and my left foot. Radiotherapy with the new machine has helped me a lot. Even just after one month here, I’m feeling much better, I can now move my hand and walk again,” said E.D. The IAEA is helping Albanian Government to treat cancer patients and has supported the installation of the latest linear accelerator machine. About 7000 cancer cases are reported in Albania every year. It is estimated that at least 50% of those need radiotherapy treatment, which they can only receive at Mother Teresa Hospital. Following the installation of the new machines, the hospital now has the capacity to treat about 1350 cases per year, which has reduced the waiting list from three months to three weeks. **Access to medical treatment is a human right.**



**QASJA NË TRAJTIM
MJEKËSOR ËSHTË NJË
E DREJTË E NJERIUT.**

**ACCESS TO MEDICAL
TREATMENT
IS A HUMAN RIGHT.**

Alesio është një 23 vjeçar që jeton në Tiranë, i cili është detyruar të bëjë një jetë të dyfishtë që kur ishte adoleshent.

“Familja ime nuk ka dijeni mbi orientimin tim seksual. Vëllai im ka pasur dyshimet e veta, që na kanë futur në sherr për qindra herë. Për mua, jeta që bëj është normale, por familja ime nuk do ta kuptonte këtë gjë”. Alesio nuk ka dalë hapur për orientimin e tij seksual. “Në të shkuarën, jam përballur me diskriminim në rrugë. Njerëzit më kanë sharë dhe më kanë ngacmuar. Ndaj tani e mbaj këtë gjë për vete dhe mundohem të mos e ekzagjeroj me mënyrën si vishem e si sillem”.

Studimi i fundit i mbështetur nga PNUD, i botuar në muajin dhjetor 2017, tregon se 92 nga të anketuarit thonë se nuk duan të kenë të bëjnë me njerëzit e komunitetit LGBTI. Vetëm 17% e bizneseve në Shqipëri përfshijnë terma si orientimi seksual dhe identiteti gjinor në politikat e tyre të punësimit me mundësi të barabarta për të gjithë. Vetëm 3 për qind e kompanive

kanë politika lehtësuese në punësimin e personave LGBTI.

Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri kanë mbështetur qeverinë dhe institucionet mbikëqyrëse - Avokatin e Popullit, Komisionerin kundër Diskriminimit - për të përmirësuar kapacitetet e tyre në trajtimin e diskriminimit kundër personave që i përkasin këtij grupi. Në muajin dhjetor 2016, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) nisi nismën e Kombeve të Bashkuara “Të Lirë dhe të Barabartë” - një fushatë e paprecedentë informuese e publikut me qëllim promovimin e të drejtave të barabarta dhe trajtimit të drejtë të personave LGBTI. Fushata “Të Lirë dhe të Barabartë” në Shqipëri përcjell një mesazh kryesor: Të drejtat e LGBTI janë të drejta të njeriut. U organizuan takime rajonale si pjesë e fushatës të Lirë dhe të Barabartë, të cilat mblodhën qindra të rinj për të folur për të drejtat e personave LGBTI.



Alesio is a 23-year-old man living in Tirana who has been forced to lead a double life since he was a teenager.

“My family does not know about my sexual orientation. My brother had his suspicions, which led us to having numerous fights. To me, the life I lead is normal, but my family wouldn't understand that. Alessio has not come out openly. “In the past, I would encounter discrimination in the street. People have said offensive things and harassed me. So now I just keep to myself and try not to exaggerate the way I dress and act”.

The latest UNDP supported survey released in December 2017, shows that 92 of the respondents declare that they would not interact with LGBTI people. Only 17% of businesses in Albania include terms such as sexual orientation and gender identity in their employment policies with equal opportunities for

all. Only 3 percent of companies have facilitating policies in the employment of LGBTI people.

United Nations Agencies in Albania have been supporting the Government and oversight institutions - People's Advocate, the Anti-Discrimination Commissioner - to improve their capacities in addressing discrimination against individuals of this group. In December 2016, the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights (OHCHR) launched UN Free & Equal - an unprecedented global UN public information campaign aimed at promoting equal rights and fair treatment of LGBTI people. “Free and Equal” campaign in Albania carries a key message: LGBTI rights are human rights. As Part of the Free and Equal campaign, regional meetings were organized which brought together hundreds of young people to talk about LGBTI rights.

ALESIO

Sentilijana është diagnostikuar me tetraplegji spastike të paralizës cerebrale, një gjendje e cila i vështirëson kontrollin e lëvizjeve të krahëve dhe këmbëve të saj.

Pa pasur ndihmë të specializuar mjekësore në vendlindje, në Lushnjë, prindërit e saj detyroheshin të bënin një rrugëtim prej 2,5 orësh dy herë në javë për të shkuar në Tiranë në mënyrë që vajza e tyre të merrte ndihmën mjekësore të posaçme që kishte nevojë. Për gjashtëmbëdhjetë vite, Sentilijana nuk mund të luante me shoqet e saj apo të kënaqej duke bërë një shëtitje jashtë. Prindërit e saj ishin shumë të frikësuar se ajo do të përjetonte bulizëm e ngacmime. Jeta e Sentiljanës dhe të ëmës së saj mori për mirë, kur në Lushnjë u hap Qendra për fëmijët me aftësi të kufizuara. Qendra ofron shërbime për 44 vajza e djem të moshës nga 5 deri 16 vjeç, të cilët janë diagnostikuar me aftësi të kufizuara intelektuale, fizike dhe ndijore. “Kur ajo erdhi në Qendër, nuk mund të ecte, mezi lëvizte duart dhe duhet të përballonte muskujt e saj të ngurtësuar që i dhembnin. Terapia e specializuar fizike që ajo merr çdo ditë po jep rezultat. Kolona e deformuar vertebrale e saj po shfaq shenja përmirësimi” thotë Ariani, - fizioterapisti që punon në Qendër. “Jeta e vajzës time ka ndryshuar plotësisht që nga momenti që erdhëm në Qendër. Pa shërbimet që merr Sentilijana, ajo nuk do ta kishte të mundur të vishej apo të ushqejë vetë. Kjo e ka ndihmuar atë të bëhej më e pavarur. “Nuk e kam parë kurrë më parë kaq të lumtur sa e shoh sot” thotë e ëma e saj. Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim ka bashkëpunuar me qeverinë shqiptare, PNUD dhe me të tjera agjenci të OKB-së për të zbatuar një program shumëdimensional “Mbështetja e OKB-së për Përfshirjen Sociale”. Programi punon për të mbështetur të



SENTILIJANA

drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuara që të bëhen pjesë e shoqërisë në tërësi, duke siguruar se ata marrin shërbime të barabarta dhe përfshirëse bazuar në nevojat që kanë, dhe se ata mund të thonë fjalën e tyre në çështje që i prekin. Jeta e një jete të denjë, me qasje në kujdes mjekësor të duhur është një e drejtë e njeriut.

Sentilijana was diagnosed with spastic cerebral palsy tetraplegia, - a condition which makes it difficult for her to control movements in her arms and legs. With no specialized medical assistance in her home town of Lushnja, her parents had to take a 2,5-hour trip twice a week to go to Tirana to get the tailored medical

assistance their daughter needed. For sixteen years, Sentilijana could not play with her friends or enjoy a walk outside. Her parents were too scared that she would experience bullying and harassment. Sentilijana and her mother's lives took a turn for the better when a Center for Children with disabilities was established in Lushnja. The center offers services to 44 girls and boys aged from 5 to 16 years old, diagnosed with intellectual, physical and sensory disabilities. “When she came to the center, she could not walk, she could barely move her hands, and had to cope with painfully stiff muscles. The specialized physical therapy she receives every day is giving results. Her deformed spinal column is showing signs of improvement” says Ariani, - the physiotherapist working at the center. “My daughter's life has completely changed since we came to the center. Without the services she receives, she would not be able to dress or feed herself. This has helped her become more independent. I have never seen her happier than she is now” her mother says. The Swiss Development and Cooperation Agency partnered with the Government of Albania, UNDP and other UN agencies to implement a multidimensional programme “UN Support to Social Inclusion”. The programme works to support the rights of people with disabilities in becoming part of mainstream society, ensuring that they receive equitable, inclusive services as per their needs, and that they have a say on issues that affect their lives. **Living decent lives, with access to adequate medical care is a human right.**

Marjo Rabiaj është një 17 vjeçar, edukator i bashkëmohatarëve të tij, nga Ballshi, Shqipëri. Mësimet mbi shëndetin seksual dhe riprodhues të kryera në shkollën e Marjo Rabiajt, në Ballsh, nga programi UNFPA Shqipëri, mbi edukimin gjithëpërfshirës seksual, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit / Institutin e Zhvillimit të Edukimit, e frymëzuan atë që të trajnohej e të bëhej vetë një edukator i bashkëmohatarëve. Ai punon në mënyrë vullnetare për një

organizatë rinore që promovon çështjet e të rinjve, duke përfshirë mënyrën e shëndetshme të jetesës, edukimin seksual dhe pjesëmarrjen e të rinjve. "Dua që të përhap fjalën te bashkëmohatarët e mi se çdo person i ri ka të drejtë të jetojë një jetë të shëndetshme dhe të ndërtojë një të ardhme të sigurt dhe se edukimi seksual na ndihmon që ta bëjmë këtë gjë," - thotë Rabiaj. Diskutimet e sinqerta në shkollë, e kanë

Marjo Rabiaj is a 17 year old peer educator from Ballsh, Albania. The sexual and reproductive health lessons introduced at Marjo Rabiaj's school in Ballsh by the UNFPA Albania programme on comprehensive sexuality education in cooperation with the Ministry of Education / Institute of Education Development, inspired him to get trained as a peer educator himself. He volunteers for

a youth organization that promotes youth issues, including healthy lifestyles, sexuality education and youth participation. "I love spreading the word among my peers that every young person has the right to live a healthy life and build a safe future, and that sexuality education helps us do that," Rabiaj says. The frank discussions in school also helped Rabiaj and his girlfriend talk

more openly about sex and their relationship, he says. "We had so many questions, which are now being answered," he says. "We feel more at ease now, we talk openly, and I think we have a healthy sexual life now and are protecting each other and helping each other stay healthy." Learning **comprehensive sexuality education** by young people in schools **is a human right.**





ndihmuar gjithashtu Rabiain dhe të dashurën e tij që të flasin më hapur për seksin dhe marrëdhënien e tyre, thotë ai. “Ne kishim shumë pyetje, të cilat tani po marrin përgjigje”, - thotë ai. “Tani e kemi më të lehtë, flasim hapur dhe mendoj se kemi një jetë seksuale të shëndetshme duke e mbrojtur dhe ndihmuar njëri-tjetrin për të qëndruar të shëndetshëm.” Mësimi i edukimit gjithëpërfshirës seksual nga të rinjtë në shkolla është një e drejtë e njeriut. **Miranda Hajdini është Koordinatorja Kombëtare për Sistemin e Informacionit të Menaxhimit Logjistik për Shpërndarjen e Kontraktivëve (LMIS), në Institutin e Shëndetit Publik.** Membështetjen e UNFPA në ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e LMIS, Miranda tashmë menaxhon ruajtjen e artikujve të katër llojeve të kontraktivëve modernë të marra nga furnizimet publike: prezervativët për meshkujt, kokrrat, IUD-të (pajisjet intrauterine) dhe injeksionet që janë shpërndarë në më shumë se 400 qendra të shëndetit publik në vend. “Çdo çift, grua e burrë, ka të drejtën e zgjedhjes së metodës së duhur dhe ta marrë këtë shërbim falas në sektorin publik,” - thotë Dr. Miranda Hajdini, duke shpjeguar se këto artikuj gjenden falas

Miranda Hajdini is the National Coordinator of the Contraceptives Logistic Management Information System (LMIS), at the Institute of Public Health. With the UNFPA support in capacity building and establishment of LMIS, Miranda now manages commodity storage of four types of modern contraceptives from public supplies: male condoms, pills, IUDs, and injectables, which are distributed in more than 400 public health centers in the country. “Every couple, every woman and every man have the right to choose the most appropriate method and find it for free in the public sector,” says Dr. Miranda Hajdini, explaining that the commodities can be found free of charge in all public health service delivery points in Albania. This is part of the National Contraceptive Security Strategy developed with support from the UNFPA.



MIRANDA



PLANIFIKIMI FAMILJAR ËSHTË NJË E DREJTË E NJERIUT DHE ÇDO ÇIFT E INDIVID DUHET TA GËZOJË PLOTËSISHT KËTË TË DREJTË.

Luljeta Mustafa, në moshën 32 vjeçare dhe nënë e dy fëmijëve, po priste një fëmijë të tretë, një vajzë. Pasi mori këshillimin nga qendra shëndetësore nr. 3, para katër vitesh, Luljeta vendosi të fillojë të përdori kokrrat si një metodë moderne e kontraktivëve. “Jam tepër e lumtur që pata mundësinë të zgjedh, së bashku me bashkëshortin tim, jo vetëm numrin e fëmijëve që donim, por edhe kohën kur i donim ato,” - thotë Luljeta. Mbështetja e fuqizimit të Qendrave të Kujdesit Parësor Shëndetësor në dhënien e shërbimit, është pjesë e programit të planifikimit familjar të UNFPA në vend. Çdo ditë, dhjetëra vajza e gra presin në dyert e qendrës shëndetësore për të marrë këshillim dhe kontraktivë. Planifikimi familjar është një e drejtë e njeriut dhe çdo çift e individ duhet ta gëzojë plotësisht këtë të drejtë.

Luljeta Mustafa, at 32 and a mother of two, was expecting her third child, a girl. After receiving counseling at the health center No. 3, four years ago, Luljeta decided to start using the pill as a modern contraceptive method. “I am very happy that I was able to choose, together with my husband, not only the number of children we wanted, but also when we wanted them,” said Luljeta. Supporting strengthening of Primary Health Care centers in service delivery is part of UNFPA family planning programme in the country. Every day, tens of girls and women wait at health center door to get counseling and receive contraceptives. **Family planning is a human right** and all couples and individuals must fully enjoy this right.

FAMILY PLANNING IS A HUMAN RIGHT AND ALL COUPLES AND INDIVIDUALS MUST FULLY ENJOY THIS RIGHT.

SHËNDETI ËSHTË NJË E DREJTË E NJERIUT. ASKUSH NUK DUHET TË SËMURET APO TË VDESË VETËM SEPSE NUK MUND TË PËRBALLOJË ÇMIMET OSE SEPSE NUK KA AKSES NË SHËRBIMET PËR TË CILAT KA NEVOJË.

Frederik Ndreca, 55 vjeç, nga Shkodra, besonte se ishte në gjendje të mirë shëndetësore derisa shkoi për një vizitë mjekësore rutinore tek mjeku i familjes.

Atij iu rekomandua të bënte kontrollin mjekësor falas - një paketë parandaluese në kujdesin shëndetësor parësor, që iu ofrohet të gjithë qytetarëve shqiptarë 35-70 vjeç, një herë në vit, falas. Bazuar në rezultatet e kontrollit, atij iu rekomandua një vizitë e specializuar tek kardiologu. Kardiologu e njoftoi atë për gjendjen e tij dhe rrezikun e një ataku kardiak.

Frederiku pesoi një atak kardiak të papritur. Kur u bë i vetëdijshëm, e gjeti veten në një spital privat ku dhe kishte kryer një operacion në zemër. Frederiku është rikuperuar plotësisht që nga ajo kohë. Ai ishte shumë i lumtur kur mesoi se të gjitha shpenzimet e operacionit ishin mbuluar nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

OBSH-ja avokon për shërbime shëndetësore të integruara me në qendër njerëzit, duke ofruar këshilla dhe mbështetje teknike për vendosjen e mbulimit universal me shërbime shëndetësore në thelbin e zhvillimit dhe zbatimit të politikave shëndetësore në Shqipëri.

Shëndeti është një e drejtë e njeriut. Askush nuk duhet të sëmuret apo të vdesë vetëm sepse nuk mund të përballojë çmimet ose sepse nuk ka akses në shërbimet për të cilat ka nevojë.



Frederik Ndreca, 55 years old, from Shkodra believed he was in a good health until he went for a routine medical visit at the family doctor.

He was recommended to do the free medical checkup- a Primary Health Care preventive package, offered to all Albanian citizens 35-70 years of age, on a yearly basis for free. Based on the check-up results, a specialized visit to the cardiologist was recommended. The cardiologist informed him of his condition and that a heart attack was looming.

Frederik had a sudden heart attack. When he became conscious he found himself in a private hospital where he had a cardio-surgery. Frederik is fully recovered since then. He was very surprised and happy to find out that all related expenses were covered by the Albanian Compulsory Health Insurance Fund.

WHO advocates for people-centered integrated health services by providing policy advice and technical support on placing Universal Health Coverage at the center of health policy development and implementation in Albania.

Health is a human right. No one should get sick or die just because he cannot afford prices and access the services they need.

HEALTH IS A HUMAN RIGHT. NO ONE SHOULD GET SICK OR DIE JUST BECAUSE HE CANNOT AFFORD PRICES AND ACCESS THE SERVICES THEY NEED.

TH.SH, 64 vjeç, tani është një nga 12 banorët e Shtëpisë së Mbështetur të Shëndetit Mendor në Korçë.

Pas diagnostikimit me çrregullim bipolar që nga viti 2008, ai u trajtua në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit për 8 vjet. Qëndrimi i mbyllur në spitalin psikiatrik prej vitesh pati efekt të kundërt.

TH.SH u transferua në Shtëpinë e Mbështetur të Shëndetit Mendor në Korçë, ku ai përfiton nga një plan kujdesi i personalizuar, i cili konsiston në rehabilitimin, ri-fitimin e aftësive jetesore dhe pavarësisë funksionale dhe vendosjen e ndërveprimeve shoqërore. Falë ekipit multidisiplinar të kujdesit, të udhëhequr nga Cilieta Simaku, psikologe, mbështetur nga trajnimet e organizuara nga OBSH, ai është plotësisht i aftë të kujdeset për vete, të ndihmojë me përgatitjen e ushqimit, të bëjë pazar, të shkojë në kishë dhe të bashkëveprojë me njerëzit. Shëndeti është një e drejtë njerëzore, jo privilegj.

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka dhënë një mbështetje afatgjatë për Autoritetet Shëndetësore Shqiptare në deinstitutionalizimin e njerëzve me çrregullime të shëndetit mendor përmes krijimit të shërbimeve të bazuara në komunitet, decentralizimit të shërbimeve dhe zgjerimit të mëtejshëm të rrjetit aktual të shërbimeve me orientim komunitar.



Mimosa Residence for people with mental disorders in Korca

TH.SH, 64 years old, is now one of the 12 inhabitants of the Mental Health Residential Center in Korca.

Having been diagnosed with Bipolar Disorder since 2008, he was treated in the Psychiatric Hospital of Elbasan for 8 years. Staying enclosed in a psychiatric hospital for years was counterproductive and degrading.

TSH was transferred to the Mental health Residence in Korca where he benefits from a tailored individual plan of care which consists in the rehabilitation, gain of functional independence, establishment of social interactions drive and skills and re-integrations of people like him. Thanks to the multidisciplinary care team, led by Cilieta Simaku, Psychologist, trained by WHO, is fully capable to care of himself, help with food preparation, do shopping, attend church services and enjoy interacting with people. Health is a human right, not a privilege.

World Health Organization has provided a long-term support to the Albanian Health Authorities in the de-institutionalization of people with mental health disorders through establishment of community-based services and the decentralization of services through the further extension of the current network of community-oriented services.

70
YEARS

UNIVERSAL DECLARATION OF
HUMAN RIGHTS

#STANDUP4HUMANRIGHTS